



VENDIM I PAPRANUESHMËRISË

Data e miratimit: 4 shkurt 2014

Numri i lëndës: 2013-15

Gani Zeka

kundër

EULEX-it

Paneli për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut i mbledhur me 3 dhe 4 shkurt 2013, ku të pranishëm ishin anëtarët e paraqitur në vijim:

Znj. Magda MIERZEWSKA, kryesuese
Z. Guénaël METTRAUX, anëtar
Znj. Katja DOMINIK, anëtare

Ndihmuar nga
Z. John J. RYAN, zyrtar i lartë ligjor
Znj. Joanna MARSZALIK, zyrtare ligjore
Z. Florian RAZESBERGER, zyrtar ligjor

Pas shqyrtimit të ankesës, e cila është dorëzuar në përputhje me Veprimin e Përbashkët të Këshillit 2008/124/CFSP të datës 4 shkurt 2008, Konceptin Llogaridhënës të EULEX-it të datës 29 tetorit 2009 për themelimin e Panelit për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut dhe Rregullores së Punës së Panelit me 9 qershor 2010,

Pas shqyrtimit, u vendos si në vijim:

I. PROCEDURAT PRANË PANELIT

1. Ankesa është regjistruar më 17 qershor 2013.

II. FAKTET

2. Ankuesi dhe vëllezërit e tij: B.Z. dhe R.Z. janë bashkëpronarë të disa parcelave të tokës në komunën e Lipjanit.
3. Më 12 mars 2009, ankuesi dhe B.Z. kanë paraqitur një kërkesë në gjykatën komunale të Lipjanit, ku kanë kërkuar një deklaratë se së bashku me R.Z. ata ishin bashkëpronarë të objektit të ndërtuar në pronën e tyre të përbashkët.
4. Duke u mbështetur në vendimin e kryetarit të asamblesë së gjykatësve të EULEX-it të datës 16 shtator 2010, lënda i është caktuar një gjykatësi të EULEX-it për shqyrtim, në përputhje me nenin 5.1 të ligjit mbi kompetencat, përgjedhjen dhe caktimin e lëndëve të gjyqtarëve dhe prokurorëve të EULEX-it në Kosovë (Ligji mbi kompetencat).
5. Më 14 mars 2011, gjykata ka pranuar kërkesën e sjellë nga ankuesi, ndërsa B.Z., R.Z. kanë parashtruar ankesë kundër aktgjykimit të shkallës së parë në Gjykatën e Qarkut në Prishtinë.
6. Më 10 maj 2012, me kërkesë të gjykatësit të Gjykatës së Qarkut në Prishtinë, kryetari i asamblesë së gjyqtarëve të EULEX-it ia ka caktuar këtë lëndë një trupi gjykues të përzier, të përbërë prej një gjykatësi ndërkombëtar dhe dy gjykatës të Kosovës. Ai ka gjetur se me qëllim të shmangjes së çfarëdo forme animi nga ana e gjyqësorit vendor dhe të uljes së tensioneve në mes të palëve, ka qenë e përshtatshme dhe në interes të administrimit të drejtësisë, në kuptim të nenit c) të nenit 5.1 të ligjit mbi kompetencat, që lënda t'i caktohet një trupi gjykues të përzier në procedurën e apelit.
7. Më 30 maj 2013, Gjykata e Apelit ka anuluar vendimin e kontestuar dhe ka dërguar lëndën në gjykatën e shkallës së parë për rishqyrtim. Gjykata ka gjetur se ka pasur shkelje të konsiderueshme të procedurës, vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të fakteve të lëndës dhe zbatim të gabuar të së drejtës materiale.
8. Tani për tani procedurat janë të pazgjidhura pranë gjykatës së shkallës së parë.

LIGJI NË FUQI

Ligji nr. 03/L-053 mbi kompetencat, përgjedhjen dhe caktimin e lëndëve të gjyqtarëve dhe prokurorëve të EULEX-it në Kosovë

Neni 5

Kompetenca e gjyqtarëve të EULEX-it për lëndët civile

5.1 Gjyqtarët e EULEX-it të caktuar në procedurë civile do të kenë kompetencë të përgjedhin dhe marrin përgjegjësi, në pajtim me kryetarin e asamblesë së gjyqtarëve të EULEX-it dhe në përputhje me modalitetet për përgjedhjen dhe caktimin e lëndëve të përcaktuara nga asambleja e gjyqtarëve të EULEX-it për:

- (a) lëndët që janë në kompetencë të Odës së Veçantë të Gjykatës Supreme të Kosovës lidhur me çështjet që kanë të bëjnë me Agjencisë Kosovare të Mirëbesimit të lidhura, përfshirë këtu lëndët që i janë referuar ndonjë gjykate tjetër në pajtim me ligjin në fuqi;
- (b) lëndët që janë në juridikcion të cilësdo gjykatë në Kosovës lidhur me ankesat kundër vendimeve të Komisionit Kosovar për Kërkesa Pronësore të Kosovës në pajtim me ligjin në fuqi;
- (c) çdo lëndë të re apo të pazgjidhur civile që ka të bëjë me pronën, përfshirë këtu ekzekutimin e procedurave që janë në juridikcion të cilësdo gjykatë në Kosovë, nëse:
 - (i) ekziston dyshimi i bazuar i përpjekjeve për të ndikuar në paanësinë apo pavarësinë e gjyqësorit vendor; ose
 - (ii) ekziston dyshimi i bazuar se gjyqësori vendor nuk është i gatshëm apo është i paaftë që ta shqyrtojë lëndën siç duhet; apo
 - (iii) ekziston dyshimi i bazuar në shkeljen serioze të zhvillimit të drejtë të procedurës.

III. ANKESAT

9. Ankuesi, pa u thirrur në ndonjë dispozitë të caktuara të instrumenteve ndërkombëtare për mbrojtjen e të drejtave të njeriut, pohon se procedurat gjyqësore kanë qenë tepër të gjatë. Mund të nxirret nga rrjedha e parashtrimeve të bëra nga ankuesi se ai pohon që e drejta e tij përgjykim pa vonësë të panevojshme është shkelur.

IV. LIGJI

10. Si çështje e së drejtës materiale, Paneli është i autorizuar që të përdor instrumentet e të drejtave të njeriut, siç pasqyrohet në Konceptin e Llogaridhënieve së EULEX të datës 29 tetor 2009 mbi themelimin e Panelit për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut. Me rëndësi të veçantë përgjithësisht, mund të përcaktojë standarde minimale përmes panelit janë Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore (Konventa) dhe Konventa Ndërkombëtare mbi të Drejtat Civile dhe Politike, të cilat përcaktojnë standarde minimale përmes panelit janë Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut, duke marrë parasysh kriteret e pranueshmërisë të përcaktuara me rregullën 29 të rregullores së punës.
11. Para shqyrtimit të bazueshmërisë së ankesës, Paneli duhet të vendlodhi do ta pranoj ankesën, duke marrë parasysh kriteret e pranueshmërisë të përcaktuara me rregullën 29 të rregullores së punës.
12. Sipas rregullës 25, paragrafi 1 i rregullores së punës, Paneli mund të shqyrtojë ankesat lidhur me shkeljet e të drejtave të njeriut nga ana e EULEX-it në Kosovë gjatë ushtrimit të mandatit të tij ekzekutiv në drejtësi, policisë dhe doganë.

13. Sipas rregullës 25, paragrafit 1, bazuar në konceptin llogaridhënës në OPLAN të EULEX-it në Kosovë, Paneli nuk mund të shqyrtoj procedurat gjyqësore të gjykatave të Kosovës. Paneli nuk ka kompetencë as mbi fushën administrative e as mbi fushën juridike të punës së gjykatave të Kosovës. Paneli tashmë ka konstatuar që edhe pse gjykatësit e EULEX-it janë pjesë e trupit gjyques të ndonjë gjykatë të caktuar, kjo nuk e ndryshon faktin se ajo gjykatë është pjesë e sistemit gjyqësor të Kosovës (ndër shumë autoritete të tjera, shih nr. 2012-02; § 21; Z kundër EULEX-it, nr. 2012-06, § 31; E kundër EULEX-it, 2012-17, § 23).
14. Paneli vijon se ankesat që janë ngritur nga ankuesi në këtë lëndë nuk hyjnë në kuadër të mandatit të Panelit, siç saktësohet nga rregullën 25, par. 1 i rregullores së punës dhe të OPLAN-it të EULEX-it në Kosovë.

PËR KËTO ARSYE,

Paneli njëzëri konstaton se nuk ka kompetencë për ta shqyrta këtë ankesë, pasi ajo nuk del jashtë kompetencave të tij, sipas nenit 29 (d) të rregullores së vet të punës, dhe

SHPALL ANKESËN TË PAPRANUESHME.

Për Panelin,

John J. RYAN
Zyrtar i lartë ligjor



Magda MIERZEWSKA
Kryesuese